



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.13, datë. 02.04.2024

PËR

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN: "PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS
EKZISTUESE, I OBJEKTEVE SI DHE NDËRTIMI I OBJEKTEVE TË REJA NË PIKËN
KUFITARE "QAFË THANA", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË PRRENJAS"

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Pogradec, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese, i objekteve si dhe ndërtimi i objekteve të reja në pikën kufitare "Qafë Thana", me vendndodhje në Bashkinë Prrenjas", me zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Pogradec.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Prrenjas.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastruktures dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLËKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 25/07 2024